



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“MARKSHAJDERI”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

I2-III-16

Tiranë, Maj 2016

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	MARKSHAJDERI			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	I2-III-16
Qëllimi:	<p>Qëllimi i kualifikimit profesional “<i>Markshajderi</i>”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar, që lidhen drejtpërdrejt me fushën e Minierave dhe në shërbimet e ofruara nga këto fusha, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “<i>Markshajderi</i>”, të nivelit të tretë në KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë përfunduar kualifikimin profesional “<i>Gjeologji-Miniera</i>”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “<i>Markshajderi</i>”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë, individit ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV të KSHK, referuar nivelit IV të KEK, teknik/menaxher.</p> <p>Me arsimim të mëtejshëm ai fiton të drejtën e Diplomës së “<i>Maturës Shtetërore Profesionale</i>” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p> <p>Ky arsimi profesional i jep individit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si punëtor i kualifikuar në sipërmarrje të ndryshme minerare që kryejnë veprimtari për kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e vendburimeve të mineraleve të dobishme.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Nuk ka			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë të:

Të përgjithshme

- Të përshkruajë mënyrat e hapjes së punimeve minerare;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik të minierës;
- Të listojë llojet e punimeve minerare
- Të përshkruajë punët e shpim-plasjes në miniere;
- Të listojë makineritë që përdoren në miniera;
- Të përshkruajë sistemin elektrik dhe pajisjet elektrike që përdoren miniera;
- Të dallojë proceset për rrëzimin e shkëmbit dhe mineralit;
- Të përshkruajë proceset e transportit në miniere;
- Të dallojë zonat e rrezikshme në miniera dhe masat mbrojtëse që duhen marrë;
- Të përshkruajë masat për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar nga shfrytëzimi;
- Të zbatojë rregullat e veshjes dhe mirëmbajtjes së uniformës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe të higjienës së mjeteve të punës, pajisjeve dhe vendit të punës;
- Të përzgjedhë mjetet e punës dhe pajisjet e nevojshme;
- Të zbatojë detyrat e personelit në repart sipas hierarkisë së organizimit;
- Të zbatojë procedurat e sigurisë në punë në lidhje me situatat emergjente të mundshme në repart (zjarr, emergjenca mjekësore..etj.);
- Të mirëmbajë mjetet e punës, pajisjet dhe makineritë në repart;
- Të zbatojë legjislacionin e punës në të gjithë elementët e tij;

Komunikimi

- Të dallojë rregullat për një komunikim të suksesshëm në vendin e punës (iniciativës, korrektësisë, vetëkontrollit);
- Të argumentojë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e punës në grup në repart;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e koordinimit të veprimtarive me kolegët dhe vartësit;
- Të argumentojë rolin e TIK në komunikimin global (reklama, shitje, blerje, etj.).

Orientimi dhe matjet në miniera

- Të përshkruajë proceset e orientimit të punimeve minerare;
- Të përshkruajë mënyrat e matjes në minierë;
- Të përshkruajë matjet Markshajderike në blloqet e shfrytëzimit me busull të varur
- Të përshkruajë hedhjen e matjeve në planimetritë e punës së minierës.
- Të përshkruajë metodat e kryerjes dhe llojet e matjeve të nevojshme për takimin e punimeve me ballë të kundërt;
- Të përshkruajë matjet e stoqeve të mineralit e të sterilizimit.
- Të përshkruajë piketimet e thjeshta në territorin e fushës minerare.
- Të përshkruajë metodat e rilevimit të punimeve minerare;

- Të përshkruajë metodën e ndërtimit të profileve, prerjeve dhe projeksionit vertikal;
- Të përshkruajë pasaportat e punimeve minerare;
- Të listojë pajisjet dhe instrumentet që përdoren për orientimin e punimeve minerare;
- Të përshkruajë instrumentet e matjeve në minierë (Total Station);
- Të përshkruajë Busullën gjeologjike dhe busullën e varur;
- Të përshkruajë Aparatet GPS portable;
- Të përshkruajë Nivelën;
- Të përshkruajë Planimetritë minerare;
- Të listojë llojet e dokumentacionit që përdoret në miniera;
- Të përshkruajë mënyrën e realizimit të matjeve mujore në punimet e shfrytëzimit.
- Të përshkruajë mënyrat e dhënies dhe kontrollit të drejtimit të punimeve minerare horizontale;
- Të përshkruajë mënyrat e dhënies dhe kontrollit të drejtimit të punimeve minerare të pjerrëta;
- Të përshkruajë mënyrat e dhënies dhe kontrollit të drejtimit të punimeve minerare vertikale;
- Të përshkruajë mënyrat e dhënies dhe kontrollit të drejtimit të punimeve minerare gjeologjike, shpime, dhoma sondash, etj.

Hapja e punimeve, shfrytëzimi i mineralit

- Të përshkruajë llojet e punimeve minerare
- Të përshkruajë sistemet e shfrytëzimit;
- Të përshkruajë proceset e rrëzimit të mineralit në nëntokë;
- Të përshkruajë llojet e armatimit në punimet minerare;
- Të përshkruajë mënyrat e transportit në minierë;
- Të përshkruajë procesin e ajrimit të minierës;
- Të përshkruajë mënyrat e ndriçimit në minierë;

Shëndeti, siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë rregullat kryesore të sigurimit teknik në miniera;
- Të përshkruajë rreziqet e ndryshme që mund të shfaqen në punën në miniera;
- Të përshkruajë pajisjet mbrojtëse individuale në miniera;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse nga pajisjet elektrike;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse gjatë avancimit të punimeve minerare horizontale, të pjerrëta dhe vertikale;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në frontin e shfrytëzimit të mineralit;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në punët me lëndë plasëse;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në punët e rrëzimit të shkëmbit dhe mineralit;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në punët e ngarkimit;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në punët e transportit;
- Të përshkruajë dhënien e ndihmës së parë në minierë;
- Të dallojë rrugët dytësore të kalimit në rast zjarri, apo eksplozioni;
- Të përshkruajë parimet dhe hapat që ndiqen për të mbrojtur dhe rehabilituar mjedisin e dëmtuar nga shfrytëzimi mineral;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Të përgjithshme

- Të mbajë pastër veglat dhe vendin e punës;
- Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të kryejë kontrollin teknik të vazhdueshëm të veglave, pajisjeve dhe makinerive që përdor;
- Të respektojë standardet dhe etikën e profesionit;
- Të lexojë dhe interpretojë skica, vizatime dhe dokumentacion teknik;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit;
- Të kontrollojë cilësinë e punës së kryer;

Komunikimi

- Të zbatojë rregullat për një komunikim të suksesshëm në vendin e punës (iniciativës, korrektësisë, vetëkontrollit);
- Të punojë në grup / ekip duke bashkëpunuar me sektorët e tjerë;
- Të diskutojë në mënyrë profesionale me kolegët në vendin e punës;
- Të respektojë komunikimin sipas hierarkisë;
- Të zbatojë orarin e punës dhe detyrat sipas përshkrimit të vendit të punës;
- Të demonstrojë aftësi në përdorimin e TIK në komunikimin global (reklama, shitje, blerje, etj.);

Orientimi dhe matjet në miniera

Të orientohet me hartë topografike në sipërfaqe;

- Të nxjerre koordinatat nga Hartat topografike dhe Planimetritë minerare;
- Të orientohet me planimetri në karrierë;
- Të ndjekë drejtimin e ecjes së shkallëve në karrierë;
- Të masë lartësinë dhe pjerrësinë e shkallëve në karrierë;
- Të ndërtojë një skicë të thjeshtë dore të një shkalle në karrierë;
- Të orientohet me planimetri në nëntokë;
- Të përdorë sinjalet dhe latën;
- Të vendosë pika markshajderike në nëntokë dhe sipërfaqe;
- Të ndjekë punimet e një nënkati në minierë;
- Të ndjekë drejtimin e një punimi horizontal;
- Të krijojë dosjen e dokumentacionit teknik për një front shfrytëzimi.
- Të kryejë matjet mujore në poligonet e punimeve të shfrytëzimit.
- Të kryejë kontrollin dhe drejtimin e punimeve minerare në planin horizontal dhe të pjerrët;
- Të bëjë matjet e nevojshme Markshajderike në blloqet e shfrytëzimit dhe të ndërtojë planimetrinë e punës 1:200;
- Të spostojë pika Markshajderike në nëntokë;
- Të bëjë matjet e stoqeve të mineralit e sterilit me forma pak a shume të rregullta;
- Të bëjë piketime të thjeshta në territorin e fushës minerare;
- Të bëjë matje me instrument në punimet minerare nëntokësore dhe në sipërfaqe;
- Të bëjë llogaritjet përkatëse dhe hedhjen e punimeve në planimetritë e punës;
- Të japë drejtimin e punimeve horizontale;
- Të kontrollojë drejtimin e dhënë në punimet që avancojnë;
- Të bëjë rlevime të sipërfaqeve të vogla;
- Të ndjekë dhe kontrollojë pjerrësinë e shinave;

- Të ndjekë dhe kontrollojë pjerrësinë e Dishinderive;
- Të ndjekë dhe të lidhe dy nënkate me furnele;
- Të ndërtojë profilet, prerjet dhe projektionin vertikal;
- Të mbajë evidence të rregullt mbi prodhimin e nxjerrë sipas blloqeve, horizonteve dhe trupave minerare;
- Të kryejë matjet Markshajderike në blloqet e shfrytëzimit me busull të varur;
- Të hedhë në planimetrinë e punës matjet e kryera;
- Të matë dhe llogarisë volumin e një stoku të thjeshtë;
- Të përdorë Busullën gjeologjike dhe busullën e varur;
- Të përdorë Aparatet GPS portable për rilevimin e një shkalle të karrierës;
- Të përdorë Nivelën për të llogaritur kuotat e shinave.

Hapja e punimeve dhe shfrytëzimi i mineralit

- Të përcaktojë vendin e stokimit të sterilizimit ose mineralit;
- Të ndjekë në praktikë punimet në shkallët e karrierës;
- Të kryejë veprime konkrete në ndërtimin e armaturave të ndryshme;
- Të përdorë elektrovozin;
- Të përdorë aparatet matëse të ajrimit;
- Të kryejë veprime praktike ndihmëse për kontrollin e sistemit elektrik në sipërfaqe;
- Të përdorë pajisjet individuale të ndriçimit;
- Të karikojë pajisjet individuale të ndriçimit;

Shëndeti, siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të punës në minierë;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti në minierë;
- Të kryejë veprime praktike për rrethimin e zonave të rrezikshme në kariera;
- Të shfrytëzojë rrugët dytësore të kalimit në rast zjarri apo eksplozioni;
- Të kryejë punime rehabilituese (mbjellje pemësh) në kariera;

KOMPETENCA TË PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e

objektivave të pranuar.

- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.